

ΜΡ ΘΥ
Ἡ ΓΛΥΚΟ ΦΙΛΟΥΣΑ
ΙΣ ΧΣ

# R R U S A R I I

# I

# Z O N J Ë S V I R G J Ë R Ë

( M E MENDIME PËR ÇDO MISTER)

Boton 'Mondo Albanese'
te Sklitsa - HORA e t'Arbereshevet
1985

Ki librush kle hartuar nga Papa Gjergjë Skjiroi te moi i Tetorit 1985 sa të jet dhuruar atireve çë ven te Klisha e vogël e Shë'Mërìs nga mbrëma sa të then rrusariin, me shpresën se do t'jen ndihur t'e then më mirë.
'Mendimet' janë marrë nga libri EVERYDAY PRAYER BOOK by Dermot Hurley, London, G.Chapman, 1972.



O Zonja e Parraisit, na tek Ti vijëm e kuturisemi. Gjithë shpresën t'ënë e kemi tek TI. Ti na ruan nën shpagarit t'ënt, o Mëza jonë.

Te Mëma e t'Lartit gjithë nanì po t'hjidhemi,na fajtorë edhè të mjerë i përujemi;nga thelbi i zëmbrës po tue thirrë Asaj në pendim: ZONJEZE e përmallshëme,na jip ndihmën t'ënde shpejt se jemi e sbiremi për lusmën e mëkatëvet.Mos le pa-hir të dhënët e tu,se Tij shpresë na kemi t'vetëme;

**Ndë èmër t'Jatit,t'Birit e të Shpirtit Shejt. Ashtù kloft.**

Paçe lipisì për mua,o i Madh'in'Zot! U ndìrnj prndìm,o i Larti Perëndì, dhëmbem e helmonem me gjithë zëmërë për gjithë mëkatët çë kam bër te gjella jime. Helmonem se kam sbièrrë parraisin e më nget pisa;po më shumë më dhëmb zëmbra ,se,tue mëkatruar,kam ftesur Tij,o i Madh'in'Zot,çë je gjithë E MIRA e çë ka ' dua mirë mbi gjithë shërbiset. U të taks me të vërtetë, me ndihmën t'ënde të mos Të ftes me mëkatën t'ime. **Vdeksha më mirë !** Po Të dafsha mirë e të shërbefsha Tij,o i Madh'in'Zot , e klofsha me Tij për gjithë monë Ashtù kloft.

O Zonja Virgjërë e Shë'Mërì,dua sot të të thom rrusariin shejt e të truhem fort mos më lipset kurr lipisia e t'in'Zoti.

**ATI I JINE**

Ati i jinë çë je ndë kjìell, shejtëruar kloft èmbri i jit, arthët rregjëria ejote,u bëft vullimi i jit , si ndë kjìell ashtù në dhe.
Bukën t'ënë të përditçmen ëna neve sot,ndëjena dëtirët t'ona, ashtù si edhè na ja ndëjèjëm dëtëruamëvet t'anë e mos na le të biem ndë ngarie,po lirona nga i ligu . Ashtù kloft .

**FALEM MERI'**

Falem,Mërì,e hir-plota;in'Zot ë me Tij.Bekuarë Ti je mbi gjithë grat e bekuarë pema e gjirit t'ënt Isuthi.
E Shë'Mërì,Mëma e t'in'Zoti,parkalès për ne të mëkatruamit nanì e te hera e vdekjies t'ënë. Ashtù kloft.

# M I S T E R E T



NGA PARRAISI NJË I DËRGUAR
PRURI FIALËN PËR TË RRUAR
E KUR UJI KRIET MËRIA
TE AJO ZURI PERËNDIA
.



Le t'mendojëm skurse shohiëm t'ën'Zonë çë merr të Jëmën e 'Tij ,shpirt e kurm, në kjlell sa t'jet atjè e lume për gjithëmonë me të Birin.

Lëvdomie e thomii:

**FALEM MËRI E HIR-PLOTA**
dhe e plotë me lëvdì e lumërì për gjithë monë bashkuarë Birit t'ënt

**IN'ZOT Ë ME TIJ**

jit Bir të dëftonet nanì si Perëndia jit

**BEKUARË TI JE MBI GJITHË GRAT**
përçë kurmi jit u ngjall e Ti je, shpirt e kurm,te lëvdia e kjlellit

E **BEKUARË PEMA E GJIRIT T'ËNT IISUI** çë nderòn Kurmin t'ënt nga i çili jerdhi Kurmi i 'Tij.

E SHE MËRI MËMA E T'IN'ZOTI PARKALES PÈR NE TE MEKATRUAMIT NANI' E TE HERA E VDEKJIES T'ËNË ASHTU' KLOFT.



MBRETËRËSHA AJO NDË KJELL
THRONI I 'SAJ SHKËLKJEN SI DIELL
ISHT HAREJA E FAREMIRIT
NUSE MËMË E BIJA E T'BIRIT

Mendojëm sikurse jemi
e bëjëm dhromin mr Shë
Mërìn për shpin e Lisa-
betës e të shohiëm dy
kushiririrat të përpikjen.



Le t'i thomi Shë Mërìs:

**FALEM MERI' E HIR-PLOTA**

e plotë me shejtërì e dashurì,pa
pasur as më të voglën ngjolle më-
katie

**IN'ZOT ë ME TIJ**

te gjiri jit te ki dhrom dashurie

**BEKUARë TI JE MBI GJITHë GRAT**

përçë Ti vetëm je Mëma e t'in'Zoti

**E BEKUARë PEMA E GJIRIT T'ëNT IISUI**

i çili të gëzonet pse je e përmal-
lshme dhe e ëmbël !

E SHë MëRI' MëMA E T'IN'ZOTI
PARKALES PëR NE Të MëKATRUAMIT
NANI E TE HERA E VDEKJIES T'ënë
ASHTU'KLOFT.




MBI TSA KASHTË E TE NJË SHPELLË
KUR ISHË NATA SHUM'E THELLË
U LE DIALI I KRIETARIT
NË MES S'KAUT EDHÈ GOMARIT



Mendojêm skurse ndodhe-
mi te shpella e Betle-
mitme shê Mërìn e të Bi-
rin IISUIN çë nanì nanì ler.
Ļe t'i thomo ASAJ:

**FALEM MERI' E HIR-PLOTA**
sa e hjìeshme duke me t'ët Bir
sapo ler
**IN'ZOT E ME TIJ**
nd'anëzë Tij te grazhdi a me Tij
n'krahë
**BEKUARE TI JE MBI GJITHBE GRAT**
përçë jit BIR e PERENDIA.
**E BEKUARE PEMA E GJIRIT T'ENT IISUI.**
çë leu sa t'na shpëtoj neve.

E SHE MERI MEMA E T'IN'ZOTI
PARKALES PER NE TE MEKATRUAMIT
NANI' E TE HERA E VDEKJIES T'ENE
ASHTU' KLOFT !



SI GJITHË T'JERËZIT FAJTORE
VIRGJËRESHA NDË FALTORE
ME TË PËRUNJUR MORI E SHKOI
E T'IN'ZOTI JA DHUROI



Le t'mendojëm sikurse jemi bashkë me Shë Mërìn kur Ajò merr Dialin IISUIN te Faltorëja e Jerusalimit sa t' E falënjë Perëndìs, si urdhuroj Liqjia e Moiseut, si një dëftesë marrëveshie dhe nderimi. **Thomii Sh.Mërìs:**

**FALEM MËRI E HIR-PLOTA**
çë bashkone me t'ët Bir si fal vetëhèn e 'Tij Perëndìs
**IN'ZOT Ë ME TIJ**
si Ti vërren Priftin çë fal ATE Perëndìs
**BEKUARË TI JE MBI GJITHË GRAT**
përçë Biri çë Ti je fal ë PERENDIA.
**E BEKUARË PEMA E GJIRIT T'ËNT IISUI**
i çili fal gjellën e vdekjien e 'Tij Perëndìs.

E SHË MËRI'MEMA E T'IN'ZOTI
PARKALES PËR NE TË MEKATRUAMIT
NANI' E TE HERA E VDEKJIES T'ËNË
ASHTU' KLOFT.



KUR I LARTI BIR U SBUAR
VEJ SHË MBRIZA TUE KËRKUAR
MBI TRI DITË TE KJITETI
NDËR TË DIJTURIT E GJETI



Le t'mendojëm sikurse jejemi e shohiëm Shë'Mërìn çë gjen Iisuin pas tri ditë çë E kërkoj.
Le të gëzonemi me Shë'Mërin e t'I thomi me harè:

**FALEM MËRI', E HIR-PLOTA**
e gëzuame se gjete Birin t'ënt
**IN'ZOT E ME TIJ**
pameta me Tij pas tri ditë helmi se E kishe sbjerrë
**BEKUAR TI JE MBI GJITHË GRAT**
përçë Biri çë Ti gjete isht **IME ZOT**
**E BEKUARË PEMA E GJIRIT T'ËNT IISUI**
çë të dha gëzimin t'E gjeje.

E SHE' MERI MEMA E T'IN'ZOTI, PARKALES PËR NE TE MEKATRUAMIT NANI' E TE HERA E VDEKJIES T'ËNË ASHTU' KLOFT.

# MISTERET



BRËNDA KOPSHTIT PARKALES
I PAVDEKTI NDIEN SE VDES
PSHERËTIN TUE DIRSUR GJAK
SE ME ATË NJË TROLLI U LAK

# E HELMËVET

Le t'mendojëm sikurse ndodhemi me Shë Mërìn si A-jò gjegjet sa isht e vuan i Biri te Kopshti i ullinjëvet.. Kërkojëm t'E ngushëllojëm e t'I thomi:



**F A L E M M Ë R I E HIR-PLOTA**
dhe e plotë me helm
**IN'ZOT E ME TIJ**
te mendia jote, te zëmbra jote si Ti gjegje çë isht e vuan
**BEKUARE TI JE MBI GJITHË GRAT**
përçë Ti me-hir le Isuthin të vuaj për ne
**E BEKUARE PEMA E GJIRIT T'ËNT ISUTHI** çë kujton mëkatët t'ona e mbigjithë do të vdesënjë për ne.

E SHE'MERI MËMA E T'IN'ZOTI, PARKALES PËR NE TE MEKATRUAMIT NANI E TE HERA E VDEKJIES T'ËNË ASHTU' KLOFT.



SI NJË KJENKJËTH E RRËMBIEN
E PËSHTIJTËN E SHKARZIEN
ME SHKUPINJE E VRAN E E SOSËN
GJITH'E MURRËN, E LAVOSËN



LE t'mendojëm skurse jemi bashkë me Shë Mërìn kur Ajò qieqjet mbi të të dërsëlluarit e të Birit. Le t'klam me Shë' Mërìn pse janë mëkatët t'ona çë jan'e i rrahìën të Birin e i thomi:

**FALEM MERI' E HIR-PLOTA**
dhe e plotë me fukjì s'larti

**IN'ZOT E ME TIJ**
sa t't'japënjë këtë fukjì çë të duhet sa t'vuash bashkë me t'ët Bir

**BEKUARE TI JE MBI GJITHE GRAT**
përçë Ti na do akjë mirë njer të vuash me Iisuin t'ënt për ne .

**E BEKUARE PEMA E GJIRIT T'ENT IISUI,**
mishët e t'Çilit kle shkjerrë për mëkatët mishi t'ona.

E SHE MERI MEMA E T'IN'ZOTI, PARKALES
PER NE TE MEKATRUANIT NANI E TE HERA
E VDEKJIES T'ENE ASHTU' KLOFT!



MBRET I FALUR PËR TË KJESHUR
ME NJË TSOPË TË KUKJIE I VESHUR
I VUN GLËMBASH NJË KURORË
E PËR SHKOP NJË KALLËM NË DORË

Le t'mendojëm sikurse jemi bashkë me Shë Mërìn kur i rrëfiejën mbi ushtarët çë i shahiënerrahiën të Birin të çilit i vun edhè një kurorë glëmbash mbi kriet.



Kërkojëm t'E ngushëllojëm e t'i lëvdojëm mirësìn tue thënë:

**FALEM MERI' E HIR-PLOTA**
çë je vuan akjë se zëmbra isht e të pëlsèt

**IN'ZOT E ME TIJ**
akjë se Ti ndìen te zëmbra jote të sharit e të rrahurit e Birit t'ënt.

**BEKUARE TI JE MBI GJITHE GRAT**
përçë Ti i dhe t'Birit t'Perëndìs kurmin sa mënd't'vuaj të shpërblej neve.

**BEKUARE PEMA E GJIRIT T'ENT IISUI**
çë rìen të dhëmburit e glëmbavet për mëkatët mendie t'ona.

E SHE MERI MEMA E T'IN'ZOTI PARKALES PER NE TE MEKATRUAMIT NANI E TE HERA E VDEKJIES T'ENE ASHTU' KLOFT.



E GJYKUAN SI NJÊ KUSAR
SI NJÊ VRASÊS PÊR TÊ VRAR
KUSH E NËM E KUSH E RRAH
KUSH E SHAN ME KRIKJIEN N'KRAH



Le t'mendojëm skurse jemi me SHë Mërìn kur Ajò për-pikjet me të Birin te dhro-mi i Kalvariit.E sheh të kjellënjë krikjien e sheh me syt e 'Saj sa Isuthi isht e i vuan.

Lëvdomie tue I thënë:

**FALEM MËRI' E HIR-PLOTA**
çë vuan se mosgjë ndihmë mënd' t'i japësh t'it Biri'shtù i la-vosur
**IN'ZOT È ME TIJ**
përpara syvet t'atë si Aì me zi kërkon t'arrënjë te maja e malit

**BEKUARË TI JE MBI GJITHË GRAT**
përçë Kurmi i Krishtit çë vuan përposh Krikjies vien ngah TI

**E BEKUARË PEMA E GJIRIT T'ÈNT IISUI**
çê kjeh Krikjien n'angêshtim sa na tê mênd't'hijêm te Parraisi.

E SHË'MËRI MËMA E T'IN'ZOTI PARKALES PËR NE TË MEKATRUAMIT NANI E TE HERA E VDEKJIES T'ËNË ASHTU' KLOFT.

# MISTERET



SI NJË TRIM Ç'U SGJUA NGA GJUMI
MBI TRI DITË U NGJALL I LUMI
VATE PRINDRAT LIROI
E NGA I LIGU NA SHPËTOI

# E LËVDIVET



Le t'mendojëm skurse ndodhemi te Shë Mëria kur in'ZOT vien t'E gjenjë posa u ngjall sëvdekurish.

Le t'marriëm piesë te gëzimi i 'Saj e t'E lëvdojëm si na i thomi:

**FALEM MËRI' E HIR-PLOTA**
dhe e plotë me gëzimsi Ti përpjektë Ngjallurin Bir t'ënt IISUIN
**IN'ZOT Ë ME TIJ**
nani çë mundi vdekjien e jerdhi përsëri tek Ti.
**BEKUARË TI JE MBI GJITHË GRAT**
përçë jit Bir u ngre nga varri e prori në harè lipin t'ënt

**E BEKUARË PEMA E GJIRIT T'ËNT IISUI**
i ngjallur me lëvdi sa mos të vuanjë më e çë na dëfton neve se Aì vërteta ë PERENDIA.

E SHE MËRI' MEMA E T'IN'ZOTI...



MUNDËSOR MBI DYZETË DITË
TE PARRAISI KRISHTI U NGJIP
I PRITUR ME LËVDÌ
ME KENDIME E ME HAIDHÌ



Le t'mendojëm sikurse ndodhemi me Shë Mërìn kur mbi malin bashkë me Apostojit ju fal të Birit çë lëj jetën sa t'prirej te kjiellia dyzetë ditë pas Ngjallies.

Ti thomi këto fialë lëvdie:

**FALEM MERI' E HIR-PLOTA**
e gëzuame se sheh t'ët Bir të priret te kjìellia ,po çë ndihe edhè një thrime e vetëmuarë

**IN'ZOT E ME TIJ**
fakje fakje për të sprasmen herë te këjò jetë.

**BEKUARE TI JE MBI GJITHE GRAT**
përçë sheh t'ët Bir të këthehet te lëvdia e 'Tij

**E BEKUARE PEMA E GJIRIT T'ENT IISUI** çë priret në kjìell posa neve na shpërbleu e Apostojvet i dha sakramentet e 'Tij



NDË TË LUTUR SHË'MËRIA
RRIJ ME APOSTOJIT TE SHPIA
SHPIRTI I SHEJT I TAKSUR JERDHI
E MBI ATA TË MIRAT DERDHI

Mendojëm skurse jemi me Apostojit e me Sh.Mërìn Jerusalìm kur Shpirti i' Shejt jerdhi mbi atà tue dhënë atireve urtësì e fukjì sa të zëjën të shpalliën Klishën Shejte. Le të lëvdojëm Shë' Mërìn tue i thënë:



**FALEM MERI' E HIR-PLOTA**
çë ndihe Klishën ahierna si bën edhè sot

**IN'ZOT E ME TIJ**
te shpirti jit paj të Hirit të Shpirtit Shejt

**BEKUARE TI JE MBI GJITHE GRAT**
Mëma e Klishës si Mëma e Iisuit

**E BEKUARE PEMA E GJIRIT T'ENT IISUI**
çë dërgon Shpirtin Shejt sa të udhëhekjënjë e të ruanjë Klishën.

E SHE MERI MEMA E T'IN'ZOTI PARKALES PER NE TE MEKATRUAMIT NANI' E TE HERA E VDEKJIES T'ENE ASHTU' KLOFT.



KUR ARRURI DITA E THËNË
LA E BEKUAMJA JETËN T'ËNË
TE PARRAISI IN'ZOT E FTOI
ME GJITHË KURMIN FLUTUROI

# E GEZIMEVET



Mëndojëm si kur se shohiëm Shë Mërìn kur ëngjëlli Gavril i thot se ka t'jet Mëma e t'inë Zoti e se Krishti bënet njerì te gjiri i 'Saj për shpërblimin t'ënë.Prieriëm syt e mendies t'ënë tek Ajò e thomii:

**FALEM MËRI' E HIR-PLOTA**
çë gjegje ëngjëllin çë të jep të famasëshmen novë

**IN'ZOT Ë ME TIJ**
çë rron te gjiri i jit

**BEKUARË TI JE MBI GJITHË GRAT**
përçë in'Zot sglodhi Tij për mëmë

**E BEKUARË PEMA E GJIRIT T'ËNT IISUI**
çë bënet njerì sa të vdesënjë për ne.

E SHË'MERI MËMA E T'IN'ZOTI,PARKALES PER NE TE MËKATRUAMIT NANI' E TE HERA E VDEKJIES T'ËNË ASHTU' KLOFT.



VATE PRAN TE LISABETA
ZONJA VIRGJËRË E TE JETA
NG'ISHË SHËN JANI, PO U GËZUA
E TE GJIRI U SHEJTËRUA



Le t'mendojëm skur-
se shohiëm IISUIN të
lartësonjë Mëmën e Tij
te kjiellia te vendi më i
lart, mbi gjithë Engjëjit
e Shejtrat.

Lëvdomie e thomii:

**FALEM MÉRI E HIR-PLOTA**
dhe e plotë me nder e me lëvdì

**IN'ZOT Ë ME TIJ**
çë Të kurorëzon MBRETERESHA e
kjìelliavet

**BEKUARË TI JE MBI GJITHË GRAT**
mbi gjithë Engjëjit e Shejtrat

**E BEKUARË PEMA E GJIRIT T'ËNT IISUI**
përçë gjithë ki nder të jerdhi
Tij se jit Bir ë PERENDIA.

E SHE'MËRI MËMA E T'in'ZOTI, PAR-
KALES PER NE TE MEKATRUAMIT NANI'
E TE HERA E VDEKJIES T'ËNË ASHTU KLOFT.

**Na Të falemi,o Perëndeshë,**Mëmëza jonë gjith-lipisì,gjella ëmbëlsia,shpresa jonë. Na Të falemi. Tij Të thërresiëm na të shkretit bij të Evës.Mbi Tij,o Më - mepsherëtojëm tue rëkuar e tue klar te këjo jetë e plotë me lotë. Andai Ti,o Shë-Mërizë,ndihma jonë ,prir mbi ne syt t'atë me lipisì e , si sos këjo jetë e shkretë , Ti dëftona pemën e gjirit t'ënt,Isuthin. Se Ti je e ëmbël, gjithë lipisì,o Zonja Virgjërë e Shë'Mërì. Ashtù kloft .

**PARKALESI' T'IN'ZOTI**

Na të biem përmist,o i Madh'in'Zot , e të lutemi me gjithë zëmërë. Të truajëm fort Klishën shejte ; çë Ti stise në jetë e Papën shejt çë Ti vure në vend t'ënt.

Klisha jote katòlike po klofshit mundësore mbi gjithë të ligat e mbi gjithë errësirat edhè eresìt.

Mos të klofshin kurr ndajturë bijt t'atë,o i Madh'in'Zot, po klofshit pakjëja jote ndër gjithë kombet te jeta,çë Ti shpërbleve me gjakun t'ënt akjë të shtrejt.U njomshin zëmbrat e të mëkatruamëvet e gjetshin tek Ti lipisì.Të truajëm,o Zoti Krisht, gjinden t'ënë t'arbëreshe ku do ndodhen edhè janë.Ti jipi dritën të Të njohiën,hiret e bekimet sa të t'shërbejën,sa të **d e n** mirë. Të truajëm gjërìn t'ënë,mikjët, armikjët e gjithë njerì çë na truhen te parkalesia.

Rrusarii shejt çë jemi e thomi vafshit edhè për shpirtrat çë janë te purgatorii.

Sa të kemi ndëjèsat shejte,parkalèsiëm,si do Klisha shejte tue thënë: Ati i jinë.....

## LITANIA E SHE MERIS

Kjirie elèison-Hristè eleison-Kjiriè...
Gjegjêna,o Zoti Krisht
Gjegjêna,o Krisht gjegjëna

Ati i kjìelliës inZot lipisì për ne
Bir,Shpërbles i dheut in'Zot
Shpirt i Shejt in'Zot
Shejta Trinì një i vetëm in'Zot

E Shën Mërì
Shejta Mëmë e t'in'Zoti
SH. Virgjër'e virgjëravet
Mëma e Krishtit
Mëma e të hjynushmit Hir
Mëmë e dëlirë
Mëmë e ndershme
Mëmë e pangarë
Mëmë e paftesme
Mëmë e dashurë
Mëmë famasore
Mëma e këshillit i mirë
Mëma e Stisorit
Mêma e Shelbuesit

Virgjërë e prënoreme (shum'e urtë)
V.e përfalurë V. e lëvduashme
V.e pushtetshme V. lipisiare
V.e besme Paskjira e Ligjës
Throni i urtësìs Kroi i harès t'ënë
Puçer shpirtëror Puçer i prënderm
Puçer i ndritëm i të luturit
Trëndafile e mistike Pirgjë e Davidhit
Piergjë e artë Arka e Dhiatës
Dera e kjìelliës Ylli i menatës
Shëndetia e të sëmurëvet
Pështrimi i të mëkatruamëvet
Gëzimi i të helmuamëvet
Ndihma e të krështerëvet
Perëndesha e Patriarkravet
P. e Profetravet P. e Apostojvet
P. e Martravet P. e Skomollerëvet
P. e Virgjëravet P.e gjithë Shejtravet
P. çë zure pa e ngarë nga faji i par
P. e Rruazariit shejt P. e pakjies
P. Mëma e Klishës Sh.Mëriza Odhijitrie

Kjenkji i t'in'Zoti çê mêkatêt e jetês ndsìer Ndêjena,o i Madh'in'Zot
Gjegjëna o i M.Z.
Lipisì për ne.

I larti Perëndì,Biri i jit i vetëmi jerdhi te jeta,duroi,vdikjë e pran u ngjall sa t'na shpërblej gjellën e pasosme,si edhè kemi kujtuar te misteret e rrusariit.Ti,o i Madh'in'Zot, po dhurona hiret t'shejtë të mos lëm kurr dhromin e Krishtit bekuam e të kemi pra të taksurën gjellë te Parraisi ku do' trazhgojëm për gjithë monë .

O Zonja e Parraisit ,na tek Ti vijëm e kuturisemi.Gjithë shpresën t'ënë e kemi tek Ti. Ti na ruaj nën shpagarit t'ënt,o Mëmëza jonë.

Lutie Zotit Krisht
Si dajëm nga Klisha.

Isht e kjaset nata,o i Madh'in'Zot, e të më t'errëtitë zë fih e shtronet mbi dhe.Arrû hera,o Isuth,tê ndahem ngah Ti e të Të lë, o i Dashuri jim.
O Isuth,çë bekove ditën e sotme,o Iisù çë burove e mëkjose me hiret t' atë shpirtin t'im! Si Apostojit mbi malin e Taborit u deja të ngrëja këtù tendezën t'ime!

Çë shërbes i ëmbël isht të prënjë syzit t'imë e zëmbrën t'ime mbi Tabernakughin t'ënt! Isht mirë shumë të parkales e të kla si edhè të gëzonem këtù te këmbët t'ote.
Si tufat e Engjëjvet pa u lodhur Të përmisen e Të lëvdojën,edhè shpirti i jim përsbashku me dashurì të pashuashme Të lëvdon e Të haristis.
Ej u të dua mirë , o Perëndì,Të dua fort mirë! E TUE U NDAJTUR NGAH TI , te duart t'ote të lë zëmbrën t'ime.
Po përçë ngë jam u e vogëla llëmpë çë dhizet ndanëzë Teje gjithë natën?
Përçë ngë i glas lulevet cë mbëloiën me bukurë erë shpizën t'ënde. e veshken e josen dale dalë përpara Teje ?
Engjëj çë rrini këtù përpara .thonij Iisuit se dishiroja sa zëmbra jime mos të tsietej kurr të rrij gjithë natën sgjuarë për Atë. Të falem,o Zoti i jim i dashuri,jam e vete,po më 'para êm bekimin t'ënt ,ruajëmë nga gjithë armikjët e shpirtit të padukshmë. Te duart t'ote u truanj shpirtin t'im.Ruaje nanì e për gjithë monë. ASHTU' KLOFT.